

**MBI**  
**AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**KOMUNËN NOVOSELË, VLORE**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në komunën Novoselë, aktualisht njësia Administrative Bashkisë Vlorë, me objekt:“Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri më 31.05.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 99, datë 25.07.2015.

Bazuar në nenet 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 01/7, datë 25.07.2015, i ka rekomanduar z. Dritan Leli, Kryetar i Bashkisë Vlorë, në të cilën përfshihet njësia Administrative Novoselë, zbatimin e masave të mëposhtme:

**A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Komuna Novoselë nuk ka bërë botimet përkatëse, sipas fazave të hartimit dhe miratimit të Planit Strategjik i Përgjithshëm Vendor në Regjistrin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, në kundërshtim me VKM nr. 480, datë 22.06.2011 “Për miratimin e rregullores model të planifikimit” neni 5 “Zhvillimi i infrastrukturave në kushtet e zbatimit të rregullores model të planifikimit”.

**Rekomandim:** Të merren masa, nga stafi drejtues i Bashkisë Vlorë (ku është përfshirë komuna Novoselë, këtu e poshtë do të quhet Njësi Vendore e Shkrirë (NJVSH), për botimin në Regjistrin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, të Planit Strategjik të Përgjithshëm Vendor të komunës Novoselë, plan ky i miratuar me Vendim të Këshillit të Komunës nr. 101, datë 04.07.2013 dhe me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit të datës 03.07.2014, konform rregullores model të planifikimit.

**2. Gjetje nga auditimi:** Në Komunë Novoselë nuk është ngritur dhe nuk ka funksionuar Këshilli Teknik, i cili duhet të jepte mendim për shqyrtimin e kërkesës për leje dhe në lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga subjektet nëpërmjet një relacioni me shkrim, në kundërshtim me ligjin nr. 110/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, neni 70/10 “Autoriteti përgjegjës për shqyrtimin dhe miratimin e lejeve zhvillimore (leje ndërtimi, leje infrastrukture, leje e veçantë)” në pikën 1.

**Rekomandim:** Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), ku zyra e planifikimit të territorit të bashkisë, të marrë masa, që procesi i shqyrtimit të kërkesave për leje zhvillimore dhe leje ndërtimi, të asistohet nga këshilli teknik i ngritur për këtë qëllim, nëpërmjet dhënies së mendimit me shkrim, mbi të cilën duhet të bazohet vendim-marrja e autoritetit përgjegjës, menaxherit të njësisë vendore për ushtrimin e përgjegjësi të ngarkuara nga ligji për planifikimin e territorit.

**3. Gjetje nga auditimi:** Nuk është bërë depozitimi i lejeve zhvillimore në Arkivin Qendror Teknik, në kundërshtim me ligjin nr. 110/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar neni 70/12 “Depozitimi i lejes zhvillimore” pika 1 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 73-82 të Raportit të Auditimit*).

**Rekomandim:** Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), ku zyra e planifikimit të territorit të bashkisë të marrë masa që të gjitha rastet të lejeve zhvillimore të miratuara së bashku me projektet e plota të zhvillimit të dërgohen pranë Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit, brenda afatit të miratuar në përputhje me ligjin “Për planifikimin e territorit”.

**4. Gjetje nga auditimi:** Zyra e Urbanistikës e Komunës nuk ka bërë inventarizimi i dokumentacionit, kërkesat për leje, miratimet e lejeve sipas dosjeve përkatëse. Në fillim të dosjeve nuk kishte fletë inventari, ku të ishin evidentuar dokumentet me ekstremitetet e tyre, pjesë përbërëse të dosjes, duke përcaktuar numrin e fletëve të çdo lloj dokumenti. Kjo fletë inventari, duhet të ishte e nënshkruar nga personat përgjegjës, që janë përkatësisht dorëzuesi dhe marrësi në dorëzim i dokumentacionit të dosjeve të Urbanistikës, sipas kërkesave të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” .

**Rekomandim:** Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), ku zyra e planifikimit të territorit të Bashkisë, të marrë masa për të gjitha praktikat e lejeve zhvillimore të miratuara që të mbahen dhe të arkivohen në bazë të kërkesave të ligjit për arkivat, duke inventarizuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të depozituar brenda tyre, sipas ligjit për planifikimin e territorit.

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga Kryetari Komunës janë dhënë në 2 raste, Leje Zhvillimi dhe Leje Ndërtimi për zhvilluesit “Vip Saloti” shpk për punimet: “Ndërtimi i objektit Shoë Room dhe Kapanon” dhe “Jano” shpk për punimet: “Ndërtimi i objektit Magazinë per përpunimin dhe grumbullimin e ullirit, lënda e parë (shitesë në fabrikën ekzistuese)” **mbi pronë të llojit “tokë arë”**. Sipas Çertifikatave përkatëse të pronësisë të lëshuar ZRPP, në kundërshtim me VKM nr. 480, datë 22.06.2011 “Për miratimin e rregullores model të planifikimit”, Seksioni “Rastet e zbatimit, kushtet dhe rregullat e përdorimit të kësaj rregulloreje”, neni 4, pika 1/a.

**Rekomandim:** Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), ku zyra e planifikimit të territorit të bashkisë, të marrë masa, që të mos miratohen kërkesa për leje zhvillimore të subjekteve, pa ndryshuar zërin kadastral të pasurisë mbi të cilën jepet leja nga zë kadastral “tokë arë” në zërin kadastral “Truall”, në regjistrin e pasurive të paluajtshme sipas kërkesave të rregullores model të planifikimit.

**6. Gjetje nga auditimi:** Për zhvilluesin “J...” shpk, për punimet: “Ndërtimi i objektit Magazinë për përpunimin dhe grumbullimin e ullirit, lënda e parë (shitesë në fabrikën ekzistuese)” nga Zyra e Urbanistikës së Komunës në fund të procesit të zhvillimit dhe para se të miratohej Leja e Përdorimit nuk është **hartuar vërtetimi i përputhshmërisë**, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.110/2013 datë 01.04.2013 “Për Planifikimin e Territorit” të azhurnuar, neni 70/30 “Vërtetimi i përputhshmërisë së zhvillimit”, pika 1.

**Rekomandim:** Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), ku zyra e planifikimit të territorit të bashkisë të marrë masa, që pas përfundimit të afatit të lejeve zhvillimore-ndërtimore dhe punimeve të ndërtimit, si dhe para se të miratohet leja e përdorimit, nga autoriteti përgjegjës për miratim të hartohet vërtetimi i përputhshmërisë mbi bazën e verifikimit nga projektuesi, supervizori sipas akt-kolaudimit të konfirmuar edhe nga kolaudatori, ku hartuesit të shprehen, nëse ka përputhje me sipërfaqen që zë struktura e miratuar sipas lejes.

**7. Gjetje nga auditimi:** Në dokumentacionin për dhënie leje zhvillimi për zhvilluesin “Jano” shpk për punimet: “Ndërtimi i objektit Magazinë per përpunimin dhe grumbullimin e ullirit, lënda e parë (shitesë në fabrikën ekzistuese)” mungonin: miratimi për pikat e lidhjes së objektit me infrastrukturën inxhinierike nga të gjitha institucionet si SHA Ujësjellës Kanalizime Vlorë, nga CEZ për lidhjen e sheshit të ndërtimit me rrjetin elektrik, nga Albtelekomi, Inspektoriat Sanitar Shtetëror i Rrethit, Ndërmarrja e Mbrojtjes nga Zjarri, vlerësimi i Ndikimit në Mjedis nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Qarku Vlorë e shoqëruar me lejen mjedisore dhe nga Qendra kombëtare e licencimit (QKL) të METE, Studimi sizmologo-inxhinierik, ekstrakti historik i QKR për Firmën “J...”shpk, plan-rilevimi, akt-dorëzimi i sheshit të ndërtimit, genplani i objektit, në kundërshtim me ligjin nr. 110/2013, datë 01.04.2013, Seksioni II/1, “Lejet e zhvillimit, autoritetet dhe procedurat”, neni 70/16 “Bazueshmëria ligjore e kërkesës” dhe VKM nr.480, datë 22.06.2011 “Për miratimin e rregullores model të planifikimit” pika 7/11.

**Rekomandim:** Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), ku zyra e planifikimit të territorit të bashkisë të marrë masa dhe të kërkojë nga subjekti “J...” shpk që të paraqesë të gjithë dokumentacionin e cituar më sipër dhe të rivlerësojë ligjshmërinë e dokumentacionit duke marrë dhe masat administrative përkatëse. Po kështu, në asnjë rast të mos miratohen leje zhvillimore, ndërtimore dhe përdorimi të subjekteve kërkuese, pa plotësuar dokumentacionin e nevojshëm.

**8. Gjetje nga auditimi:** Nuk janë kryer procedurat e nevojshme teknike dhe ligjore, për regjistrimin në ZVRPP Vlorë në pronësi të Komunës, të pronave të pa luajtshme, të cilat me VKM nr. 311, datë 18.03.2009, kanë kaluar në pronësi të Komunës, në kundërshtim me kërkesat e nenit 25 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të pa luajtshme”, neni 30 dhe 35/a të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” .

**Rekomandim:** Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), të marrë masat e nevojshme për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm tekniko ligjor, për regjistrimin e pasurive të pa luajtshme, të cilat me vendime të Këshillit të Ministrave kanë kaluar në pronësi të Komunës.

**Gjetje nga auditimi:** Për pronat sipas VKM-ve të mësipërme, nuk ka një program të miratuar nga Titullari për ngritjen e grupeve të punës, që në momentin e transferimit e në vazhdim të kryerjes së inventarizimeve fizike, për përgatitjen korrekte të hartave dhe rakordimin e tyre me ZVRPP, në lidhje me identifikimin e gjendjes juridike të pasurive në momentin e përgatitjes së listave në të dy stadet e miratimeve me VKM dhe verifikimin në terren të ndryshimeve nga përcaktimet e listës për të bërë dhe azhurnimet përkatëse, në rast mospërputhjes në kundërshtim me ligjin nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar, me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 11/4 e nenin 12/f, me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” kap.IV .

**Rekomandim:** Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), ku të merren masa për ngritjen e një komisioni të posaçëm, për kryerjen e inventarizimit fizik dhe hartimin e planvendosjeve, saktësimin në harta në rakordim me ZVRPP në lidhje me gjendjen juridike për secilën nga pronat e përfshira në listën dhe të miratuara paraprakisht, verifikimin në terren të ndryshimeve nga përcaktimet e listës për të bërë dhe azhurnimet përkatëse në rast mospërputhjes.

**10. Gjetje nga auditimi:** Marrja në dorëzim e këtyre pronave, nuk është shoqëruar me inventarizimin fizik të gjendjes pyjore në terren, për verifikimin e përcaktimeve të pasqyrës së bashkëlidhur VKM, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 804, datë 4.6.2008, mbi “Dorëzimin e fondit pyjor dhe kullor” dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/ 26, neni 11/4 e nenin 12/f. Gjithshtu nuk është bashkëpunuar me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Pyjor, Vlorë dhe njësitë vendore kufitare, për saktësimin në hartat shoqëruese të kufijve dhe territorin e shtrirjes së këtij fondi, nën administrimin e Komunës Novoselë. Si rezultat i kësaj, nuk janë bërë akoma azhurnimet përfundimtare në hartë, për përcaktimin e kufijve administrativ ndërmjet Komunave, në kundërshtim me kërkesat e nenit 8 të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, i ndryshuar.

**Rekomandim:** Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), ku të marrë masa që të kryhet inventarizimi fizik mbi gjendjen e statusit juridik të 250.3 ha sipërfaqe tip kullota, livadhe shkëmbore me bimësi pyjore, të cilat me VKM nr. 174, datë 13.02.2008, janë transferuar në pronësi të komunës, si dhe të bashkëpunohet me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Vlorë, që të përcaktohen kategoritë, të merren hartat përkatëse me azhurnimet e ndryshimeve, ku të përcaktohen kufijtë dhe planvendosjet e tyre.

**11. Gjetje nga auditimi:** Për menaxhimin e këtyre pasurive nga Komuna nuk është përpiluar dhe miratuar plan i ri i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave, në kundërshtim me kërkesat e nenit 5, pika 5 të ligjit nr. 9585, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar ku citohet: “... planet e mbarështimit hartohen nga persona me licencë dhe miratohen në Këshillin e Komunës ..” Për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave, nuk ka raste të bashkëpunimit me Ministrinë e Mjedisit dhe shoqatat e pyjeve dhe atyre mjedisore, në kundërshtim me kërkesat e pikës 5/dh të VKM nr. 396 datë 21.6.2006 “Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore” .

**Rekomandim:** Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (ku përfshihet Komuna Novoselë), ku të merren masat e nevojshme që në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Pyjor, të hartohet plani i mbarështimit dhe ruajtjen e sipërfaqeve pyjore dhe kullotave.

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion në lidhje me fondin e parcelave të tokës me bimësi pyjore, që janë pjesë e fondit pyjor në pronësi të Komunës rezulton se janë zënë dhe shfrytëzohen nga fermerët. Për këto parcela me një sipërfaqe prej 528,700 m<sup>2</sup> ose rreth 52.9 ha nuk janë lidhur kontrata qiraje dhe nuk janë vjelur të ardhura nga tarifa e qirasë për tokë bujqësore prej 6000 lekë për ha në vit si dhe taksa e tokës në shumën 3000 lekë/ha në vit të përcaktuara në paketat fiskale të viteve të miratuara me VKK në kundërshtim me Udhëzimit KM nr.1 datë 18.7.2012 “*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*”. Për këto toka nuk janë bërë verifikimet në terren dhe azhurnimet përkatëse, si dhe nuk është hapur regjistri për evidentimin e fermerëve dhe detyrimit ligjor për taksën e tokës, të cilat këto fermerë i përdorin dhe për ndjekjen e procedurave të kontraktimit për dhënien me qira.

Për rastet e refuzimeve, nuk janë ndjekur procedurat ligjore për largimin e fermerëve nga tokat e zaptuara dhe procedimin gjyqësor të tyre. Detyrimi i lindur dhe i pavjelur nga Komuna për periudhën 2011-2014 nga fermerët që shfrytëzojnë këto parcela për taksën e tokës është në shumën **633,680 lekë** dhe për tarifën e qirasë është në shumën **1,214,458 lekë**.

Lejimi dhe përdorimi i paligjshëm e shfrytëzimi i parcelave me sipërfaqe 52.9 ha tokë me bimësi pyjore, nga fondi pyjor pasuri në pronësi të Komunës, për kultivime bujqësore, pa pasur marrëdhënie ligjore (pronësie a qiraje) lidhur me tokën është në kundërshtim me ligjin nr. 8312, datë 26.3.1998 “*Per tokat bujqesore te pandara*” neni 6, me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007 “*Për disa ndryshime ne ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” neni 40/3 me pasojë përfitime të paligjshme, që përbëjnë të ardhura të munguara për Buxhetin e Komunës në vlerën totale prej 1,848,138 lekë* .

**Rekomandim:** Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), ku të merren masa për sipërfaqen prej 52.9 ha të zaptuar dhe që shfrytëzohet nga fermerët, që të bëhen verifikime në terren dhe azhurnime përkatëse si dhe ndiqen procedurat e kontraktimit për dhënien me qira të tyre. Të hapet regjistri për evidentimin e detyrimit ligjor për shumën totale **1,848,138 lekë** (*taksë toke 633,680 lekë + 1,214,458 lekë tarifë qiraje*). Për rastet e refuzimeve, të ndiqen procedurat ligjore, për largimin e fermerëve nga tokat e zaptuara dhe procedimin gjyqësor të tyre.

**13. Gjetje nga auditimi:** Komuna ka proceduar për dhënie me qira në 1 rast, për ushtrim aktivitet biznesi në objektin “*Thertore*” me sipërfaqe totale 193.5 m<sup>2</sup> , e cila ka qenë në përdorim në vazhdimësi dhe është kontraktuar dhe për periudhën objekt auditimi. Ky objekt nuk rezulton në listën e pronave të Komunës të miratuara paraprakisht me VKM. Kontrata me nr. 63, datë 26.03.2015, **nuk është e shoqëruar me certifikatë pronësie të lëshuar nga ZVRPP në emër të Komunës, megenplan si dhe vlera kontabël e kësaj prone**, por vetëm nga hartografia. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 8.6.2011 “*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*” Kreu II “*Procedurat e dhënies me qira ose enfitozë të pasurisë shtetërore*” pika 1/e e pika 2.

**Rekomandim:** Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), ku të merren masa që objekti “*Thertore*”, të dokumentohet dhe të shtohet në listën e pronave të Komunës, para miratimit përfundimtar me VKM dhe të bëhet regjistrimi në ZVRPP, duke e evidentuar në kontabilitet me vlerën e saj.

**14. Gjetje nga auditimi:** Në pagesat për blerje me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, për vitin 2013 në 17 raste në vlerën 1,517,314 lekë, për vitin 2014 në 17 raste në vlerën 1,546,020 lekë dhe për vitin 2015 në 11 raste në vlerën 2,044,376 lekë, rezultuan mangësi dhe parregullsi në plotësimin e dokumentave pjesë të dosjes së procedurave të blerjeve me vlera të vogla si: mungojnë kërkesat për përcaktimin dhe argumentimin e nevojave për blerje, nuk ka argument të fondit limit nëpërmjet testimit të tregut nga shqyrtimi i ofertave të grumbulluara, nuk është hartuar procesverbali i shqyrtimit të tyre, ka mungesë të dokumentit të raportit kualifikimit final të miratuar nga Kryetari i AK, në të gjitha rastet mungon akti i marrjes në dorëzim dhe në rastet e punimeve apo te blerjeve të paisjeve teknologjike mungon akti i kolauditimit, në të gjitha rastet faturat e furnitorit nuk është firmosur nga anëtarët e KPVV, por nga vetë Kryetari i AK. Këto parregullsi të konstatuara janë në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për miratimin e rregullave të*

*prokurimit publik*” pikës 2/a Kreu i VI, me Udhëzimin APP nr. 2, datë 28.03.2013 “*Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla*”, me Udhëzimin APP nr. 3, datë 27.01.2015, me Urdhrin e Ministrisë së Financave nr. 33, datë 11.07.2013, me UMF nr. 57, datë 12.6.2014 “*Për Gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë*”, tabela1/3 dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011”, rubrika “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve”, pika 37 dhe rubrika “Marrja në dorëzim i aktiveve të furnizuara”, pika 42,43 dhe 44 .

**Rekomandim:** Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), ku zyra e financës së bashkisë të marrë masa, për vendosjen e rregullave për hartimin e gjurmës standarde të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, ku të përcaktohet procesi i punës, që nga hartimi i kërkesave deri në përfundimin e procedurës së prokurimit, mbi bazën e dokumenteve financiare justifikues, autorizues dhe vërtetues, duke vendosur strukturat zbatuese dhe të miratohen nga titullari.

**15. Gjetje nga auditimi:** Janë kryer pagesa shërbim interneti për vitin 2013 në 10 raste në vlerën 159,396 lekë, për vitin 2014 në 7 raste në vlerën 136,310 lekë dhe për vitin 2015 në 4 raste në vlerën 44,800 lekë pranë operatorit ekonomik “N...” shpk pa procedurë prokurimi dhe nën mungesën e një kontrate shërbimi, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin Publik*” neni 1/a, 3/4, 4, 12 dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” , Kreu I, pika 1 dhe 3/b .

**Rekomandim:** Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), ku të merren masa që blerja e shërbimit të internetit për institucionin të bëhet me procedurën e prokurimit dhe të lidhet kontratë shërbimi për sigurimin cilësor të tij.

**16. Gjetje nga auditimi:** Në 1 rast në vlerën 439,920 lekë në vitin 2013, në 2 raste në vlerën 565,200 lekë në vitin 2014 dhe në 1 rast në vlerën 224,640 lekë në vitin 2015, blerja materiale ndërtimi rërë bituminoze, çakull dhe stabilizant për mirëmbajtje rrugësh,rezulton se praktikave të tyre u mungojnë kërkesat, për përcaktimin e nevojës së kryerjes së blerjes nëpërmjet identifikimit të rrugëve, ku do të bëhen riparimet, përpilimit të skicave me përmasat dhe plan-vendosjet e segmenteve rrugore që do të riparohen. Mungon preventivi paraprak dhe në rastet kur nuk mungon është i mangët, pasi përcakton thjesht sasinë, çmimin dhe vlerën dhe nuk përcakton specifikimin teknik të këtij materiali ndërtimi, nuk ka analizë çmimi referuar manualeve të miratuara për punime të ndërtimit. Nuk ka dokumentim të volumeve të punës të kryera nga punonjësit e shërbimit, si dhe dokumentim fotografik para dhe pas kryerjes së punimeve. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar me pikën 3.1 dhe 8.3, kreu I i UKM nr.2 datë 13.05.2005. Fletë hyrja është e pa shoqëruar me aktin e marrjes në dorëzim nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, i cili bën matjet e nevojshme për sasinë si dhe verifikimin e cilësisë. Fatura e furnizuesit nuk ka të përcaktuar largësinë në kilometra nga është transportuar malli. Fletë dalja është e pashoqëruar nga një plan-shpërndarje me vend-ndodhjet, se ku do të bëhet shtrimi me rërë bituminoze apo me çakull, urdhrin e punës për kryerjen e punimeve,etj. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me nenin 4/26 të ligjit 10296, datë 8.07.2010 “*Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011”, rubrika “*Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve*” pika 36, 37, 42, 43 dhe 44 .

**Rekomandim:** Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), ku financa e bashkisë për blerjet dhe përdorimin e materialeve të ndërtimit, të plotësohet dokumentacioni tekniko ligjor për kryerjen e punimeve nga momenti përcaktimit të nevojave, deri në marrjen në dorëzim të punimeve shoqëruar nga dokumentat financiare justifikuese dhe vërtetuese financiare të hartuar konform dispozitave ligjore.

**17. Gjetje nga auditimi:** Për të 3 vitet mungon rregjistri i parashikimit dhe i realizimit të dërguar në APP, për prokurimet me vlerë të vogël në bazë të nevojave për mallra dhe shërbime, në kundërshtim me pikën 3/b të Kreut I të pikës 2/a Kreu i VI në VKM nr.1, datë 10.01.2007 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” të ndryshuar dhe me Udhëzimin Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 28, datë 18.02.2008 “*Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla*”, pika 1,4 .

**Rekomandim:** Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), ku financa e bashkisë në bashkëpunim me njësinë e prokurimit, të marrë

masa për hartimin e regjistrit të parashikimit dhe të realizimit të blerjeve me procedurën prokurimit të blerjeve me vlera të vogla dhe të depozitohet pranë APP.

**18. Gjetje nga auditimi:** Për veprimet me arkën është mbajtur vetëm libri i arkës dhe nuk është mbajtur ditar arke në formën klasike të kontabël, por në formën e një regjistri të mbajtur nga Zyra e Tatim-Taksave, duke mos i klasifikuar sipas llogarive përkatëse të klasës 7, si dhe paraqitja e tyre në pasqyrat financiare është bërë nga jashtë dhe jo sipas standarteve kontabël, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” i ndryshuar, me VKM nr.783, datë 22.11.2006 “*Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël*” dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik*” pika 61, 62 dhe 67.

**Rekomandim:** Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), ku financa e bashkisë të marrë masa për kontabilizimin e të ardhurave që nga azhurnimi i të ardhurave në librin ditar, prerjen e artikujve kontabël për llogaritë që preken, deri në paraqitjen e gjendjeve në llogaritë e klasës 7 të të ardhurave në pasqyrat financiare.

**19. Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me informacionin kontabël në pasqyrat financiare, që paraqesin në fund të vitit 2014 gjendjet e llogarive 230 “*Aktivet e Qëndrueshme të trupëzuara*” në vlerën 11,280,200 lekë, llogarisë. 212 “*Ndërtime e konstruksione*” në vlerën 62,015,788 lekë, llogarisë 213 “*rrugë rrjete vepra ujore*” në vlerën 343,651,601 lekë, llogarisë 214 “*instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në vlerën 19,961,358 lekë dhe llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” në vlerën 3,975,419 lekë rezultuan se, nuk janë të analizuar dhe për to nuk ka informacion se çfarë përfaqësojnë, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” i ndryshuar, me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “*Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël*” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 28-43 të Raportit të Auditimit*).

**Rekomandim:** Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), e cila ta marrë masa dhe të ngrëjë grup pune. në bashkëpunim me sektorin e Financës të bëjë vlerësimin dhe analizën e vlerave të paraqitura në llogaritë e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara 212-213-214-218. Po kështu të kryhet analiza e llogarisë së aktiveve të trupëzuara 230, ku vlerat analitike e projekt-studimeve të shpërndahet dhe të përfshihen në vlerat e aktiveve të trupëzuara përkatëse.

**20. Gjetje nga auditimi:** Në mbylljen e ditarëve, artikujt kontabël nuk janë hedhur në sistemin centralizator, apo në librin e madh ose mastro, në të cilën duhet të ishin pasqyruar efektet e veprimeve ekonomike të klasifikuara sipas llogarive të prekura nga azhurnimi në ditarë nëpërmjet mbartjes së shumave nga ditarët në fund të periudhës ushtrimore, procedurë kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” i ndryshuar, me VKM nr.783, datë 22.11.2006 “*Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël*”.

**Rekomandim:** Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), Zyra e Financës së bashkisë të marrë masa, që gjatë kontabilizimit dhe hartimit të bilancit të ndjekë hapat e duhura kontabël, për veprimet ekonomike të ndodhura, që nga azhurnimi në ditar, kuadrimi i shumave periodik dhe në fund të periudhës ushtrimore, prerja e artikujve kontabël, mbartja e shumave në sistemin centralizator ose në librin mastro, nxjerrja e gjendjeve të llogarive përkatëse të prekura nga veprimet ekonomike, hartimin e bilancit vërtetues, deri në hartimin e bilancit përfundimtar.

**21. Gjetje nga auditimi:** Nuk është mbajtur libri inventar me të dhënat e aktiveve të trupëzuara me azhurnimet e përditësuara, deri në momentin aktual, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” i ndryshuar, me VKM nr.783, datë 22.11.2006 “*Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël*” dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” kap III, pika 30.

**Rekomandim:** Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), Zyra e Financës së bashkisë të krijojë dhe të mbajë regjistrin e aktiveve, i cili të hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër, si dhe grupit përkatës

brenda llojit. Në këto të përfshihet: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritjen të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes deri në daljen e tij jashtë përdorimit, domosdoshmëri, kjo për të patur një evidencim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve, në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit.

**22. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi pagesave të kryera Shoqërisë “A...” shpk për “Ndërtim i Shkollës 9-vjeçare Loni Mone-Fshati Poro” të financuar nga Institucioni IADSA me përfaqësues ekzekutiv të Shtetit Shqiptar dhe atij Italian në asnjë rast të nuk është mbajtur 5% në shumën 1,755,104 lekë, si ngurtësim për garancinë e difekteve, që mund të ndodhin në punimet e ndërtimit, në kundërshtim me formularin e kontratës neni 12 i shtojcës 18 të Dokumenteve Standarte të Tenderit “Kushtet e veçanta”, ku thuhet: “12.1. Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë 5% e vlerës së situacionit të paraqitur”. Mos ngurtësimi i garancisë së difekteve, është në kundërshtim me nenin 44 të DST, me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” me pikën 6, seksioni II “Për kolaudimin e punimeve” të Udhëzimit të KM nr.3 datë 15.02.2001 “Për disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar me UKM nr.2, datë 13.05.2005, pika 6.

**Rekomandim:** Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), Zyra e Financës së bashkisë të marrë masa, që në pagesat që do të kryhen për punime ndërtimi, për çdo situacion pjesor dhe përfundimtar të paraqitur, të zbritet vlera që i takon garancisë së defekteve në masën 5 % të vlerës së situacionit, në mënyrë që të sigurohet fondi i nevojshëm për financimin e defekteve të konstatuara deri në 1 vit. Pas kryerjes së punimeve, kthimi i kësaj vlere të bëhet në bazë të aktit të marrjes në dorëzim të objektit dhe akt-kolaudimit në momentin e përfundimit të afatit të kësaj garancie.

**23. Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me kryerjen e procesit të inventarizimit për aktivet nën administrim të Komunës rezultoi se për vitin 2013 dhe 2014 komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimi nuk ka hartuar procesverbalet për argumentimin teknik të gjendjes jashtë funksionit të inventarit ekonomik, inventarit të imët në shkolla dhe Komunë. Gjithashtu mungon dokumentacioni për kryerjen e hapave të mëtejshme për tjetërsimin apo asgjësimin e tyre. Për këto vlera janë kryer veprimet kontabël, duke bërë pakësimet në llogaritë përkatëse pa i dhënë zgjidhje përfundimtare këtyre aktiveve. Kjo e procedurë e ndjekur është në kundërshtim me udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, pika 109.

**Rekomandim:** Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), Zyra e Financës së bashkisë të marrë masa dhe të procedojë, sipas kërkesave ligjore për inventarët të nxjerra jashtë përdorimi, duke kryer procesin e tjetërsimit apo të asgjësimit të shoqëruara, duke saktësuar veprimet kontabël përkatëse.

**24. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi në 3 raste në vlerën 408,100 lekë janë kryer blerje për karburant me procedurën e emergjencës të blerjeve me vlera të vogla (formati 5). Në rastin e blerjes së 1,624 litrave naftë në vlerën 281,100 lekë të datës 14.03.2013 dokumentacioni justifikues i mbajtur, nuk ka argument apo përlllogaritje mbi bazë reale për përcaktimin e koeficientëve distancat e përshkruara dhe volumet e punimeve të kryera në m3. Nuk ka asnjë praktikë, që të argumentojë dhe të përshkruajë se çfarë pjesë të situatës emergjente të përmytjeve, është përballuar dhe si është përdorur karburanti në funksion të saj. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me nenin 4/26 të ligjit 10296, datë 8.07.2010 “Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 34, 35, 36.

**Rekomandim:** Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), Zyra e Financës së bashkisë të marrë masa, që në blerjet e mallrave dhe shërbimeve në rastet e emergjencës, të argumentojë dhe të plotësojë me dokumentacion të plotë e të saktë financiar dhe mbështetës konform dispozitave ligjore.

## Në Vijimësi

**25. Gjetje nga auditimi:** Me taksat dhe tarifatat vendore u konstatua se:

**-Debitorët** e taksave vendore paraqiten në nivele të larta për vlerën **90 milion lekë** dhe nuk janë kontabilizuar, pasi zyra e taksave vendore nuk ka dërguar shkresë zyrtare sektorit të financës. Mos arkëtimi i debitorëve, mungesa e masave sekuestruese dhe të ndërhyrjes me forcë të Policisë Komunes për disiplinimin e debitorëve, bie ndesh me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" neni 88 e 93, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", neni 17 "Kundërvajtjet dhe sanksionet", pika 3, me Rregulloren e Brendshme të Komunes të miratuar në Këshillin Bashkiak neni 41 dhe 42.

**-Taksa e therjes e bagëtive** në objektin thertore, dhënë me qira subjektit *Nikos Semanjakos*, sipas kontratave datë 27.8.2014 dhe datë 26.3.2015, **nuk është vjelur** nga veterineria e komunës Novoselë për vitin 2013 dhe në vazhdim, pra nuk ka aplikuar ndaj subjektit taksën e therjes për bagëtitë e trasha dhe të imta, në kundërshtim me pikën 9 të paketës fiskale të miratuar sipas vendimit Këshillit Komunes nr.73, datë 28.12.2012 .

**Rekomandimi:** Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), Zyra e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me financën e Bashkisë dhe policinë bashkiake, të kontabilizojë debitorët dhe të marrë masa për arkëtimin e tyre, duke ndjekur të gjitha hapat ligjore deri në sekuestrim pasurie të subjekteve debitore, sipas aneksit nr. 2 bashkëlidhur raportit auditimit.

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), e cila të marrë masa dhe të kryej kontabilizimin e detyrimeve, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit me **vlerën 18,684,802 lekë** në mënyrë analitike, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Në preventivin e paraqitur në tenderin me objekt "shkolla e re Poro komuna Novoselë", nga operatori ekonomik "S...", janë paraqitur zërat e punës "pajisje" të llogaritur me gjithë vlerën e TVSH, në kundërshtim UKM nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", nuk është llogaritur veças vlera e "montimit" dhe vlera pajisjeve, kaldajë etj, por është llogaritur me gjithë TVSH, e për rrjedhojë nga operatori ekonomik "S..." vlera e tvsh është përfituar padrejtësisht në shumën **144,200 lekë** (721,000 x 20%) **dëm ekonomik** për buxhetin e shtetit .

**Rekomandimi:** Të kërkohet arkëtimi i dëmit nga subjekti "S..." **sh.p.k.** për vlerën **144,200 lekë**, e përfituar padrejtësisht, si rrjedhojë e preventivimit të pajisjeve të llogaritur me gjithë vlerën e TVSH në objektin "Shkolla e re Poro komuna Novoselë".

**2. Gjetje nga auditimi:** Në tenderin me objekt "blerje 3 automjete vetshkarkuese për nevoja të komunës Novoselë ", u konstatua se KVO ka vlerësuar 3-fish më shtrejtë automjetet për vlerën 750,000 lekë/secila, sipas dokumentave të origjinës faturës Kineze datë 18.9.2012 dhe deklaratës doganore Durrës datë 16.11.2012, pasi janë blerë me 2,360 dollarë/secila, pra nuk respektuar 2 faktorë kryesor teknik dhe ekonomik për subjektin fitues "Pr..." shpk.

Përveç kësaj, komisioni ka marrë në dorëzim 3 automjetet vetshkarkuese jo sipas specifikimeve teknike të DST, pasi janë me tonazh 960 kg nga 2,500 kg që duhej dhe fuqi motorrike 1498 Cc nga 1,800 Cc që duhej, pra automjetet janë më të vogla, çka ka krijuar probleme në çmimin e blerjes tyre, sipas procesverbalit datë 21.5.2013, lejeve të qarkullimit, aktpronësive dhe faturës së origjinës të subjektit. Për rrjedhojë vlera **759,000 lekë përbën dëm ekonomik**, për KVO dhe komisionin e marrjes në dorëzim. Veprim në kundërshtim me neni "detyrimet e palëve" të kontratës nr. 633/1, datë 16.5.2013 lidhur mes Komunës Novoselë dhe subjektit fitues "Pr..." shpk, me specifikimet teknike të DST dhe me referencat e standarteve ndërkombëtare.

**Rekomandimi:** Të kërkohet arkëtimi i dëmit nga subjekti "Pr..." shpk, për vlerën **759,000 lekë**, përkatësisht nga: Sh.M vlera 151,800 lekë, Sh.M vlera 151,800 lekë, A.H vlera 151,800 lekë, K.S vlera 151,800 lekë, L.M vlera 151,800 lekë, vlerë e konstatuar në tenderin me objekt "blerje 3 automjete vetshkarkuese për nevoja të komunës Novoselë ", të cilat janë vlerësuar në kundërshtim me referencat e standarteve ndërkombëtare dhe me dokumentat e



originës, si dhe janë marrë në dorëzim në kundërshtim me specififikimet teknike të tenderit dhe me kontratën nr.633/1, datë 16.5.2013, neni “*Detyrimet e palëve*”.

**3. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “*Rikonstruksioni i rrugës Hidrovor Akërrni faza e II*” Komuna Novoselë, nga auditimi i dokumentacionit teknik mbi hartimin e projekt–preventivit të punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike rezulton se janë preventivuar tepër fond limit, si rrjedhojë e hartimit të këtij preventivi sipas manualit të vendimit nr. 1359 datë 10.10.2008 “*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*” dhe jo sipas vendimit nr. 407, datë 27.06.2012 në vlerën 10,188,660 lekë me T.V.SH, ose 22.6 % e investimit, nga të cilat **8,996,440 lekë** me TVSH (10,188,660 –1,192,220), përbën **dëm ekonomik** ndaj buxhetit të shtetit si pasojë e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes me diferenca negative ndaj buxhetit të Komunës, çka ka sjellë mos përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të këtyre fondeve. Veprime në kundërshtim me nenin 8, Kreu II i ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, nenin 3, Kreu I të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar, me pikat 2, 3 dhe 9 të Vendimit nr. 514, datë 15.08.2007 “*Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit*, ndryshuar me vendim nr. 664, datë 26.09.2012 “*Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 514, datë 15.08.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”* si dhe me nenin 1, 2 dhe 24, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar dhe Kreu V, pika 1/a dhe pika 4/h të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*”.

**Rekomandimi:** Të shlyhet vlera e dëmit për **8,996,440 lekë**, pasi janë preventivuar më tepër fond limit, në objektin “*Rikonstruksioni i rrugës Hidrovor Akërrni faza e II*” Komuna Novoselë, përkatësisht nga:

- z. **K.Sh për 4,498,220 lekë**,
- znj. **Sh.M për 4,498,220 lekë**.

**4. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “*Ndërtimi i shkollës së re 9 – vjeçare Pilo Prifti*” Novoselë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren, rezultuan diferenca në volume punë të pakryera në vlerën **3,164,256 lekë dëm ekonomik** pa TVSH si dhe mangësi në dokumentacion. Veprime në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar.

**Rekomandimi:** Të kërkohet arkëtimi i dëmit nga subjekti BOE “*C...O*” shpk dhe “*A...*” shpk, për vlerën **3,164,256 lekë**, për punime të pakryera në objektin “*Ndërtimi i shkollës së re 9 – vjeçare Pilo Prifti*” Novoselë, sipas kontratës nr. 240, datë 13.10.2014.

**5. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “*Ndërtimi i shkollës në fshatin Poro*” Novoselë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **185,850 lekë dëm ekonomik** pa TVSH. Veprime në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar.

**Rekomandimi:** Të kërkohet arkëtimi i dëmit nga subjekti “*A...*” shpk, për vlerën **185,850 lekë**, për punime të pakryera në objektin “*Ndërtimi i shkollës në fshatin Poro*” Novoselë, sipas kontratës datë 15.8.2013.

**6. Gjetje nga auditimi:** U konstatua se për vitin 2014-2015 disa këshilltar komunës janë paguar për vlerën **221,805 lekë dëm ekonomik**, edhe për ditë që nuk kanë marrë pjesë në mbledhjen e këshillit të komunës, në mos përputhje me pikën 2 të nenit 29, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”, të ndryshuar.

**Rekomandimi:** Të kërkohet arkëtimi i dëmit për vlerën **221,805 lekë**, përfituar pagesa të paligjshme për vitin 2014-2015, nga 15 ish këshilltarët e komunës Novoselë.

**7. Gjetje nga auditimi:** Për 39 vendimet e Komunës me shkelje të dispozitave ligjore për dhëniet me qira për 99 vjet për tokat e pandara dhe praktikat e tyre për periudhën 2007-2011, Komuna Novoselë ka bërë *Kallzim Penal* të datës 26.09.2011 pranë Prokurorisë së Rrethit

Gjyqësor Vlorë sipas rekomandimeve të lëna nga Auditi i Prefekturës Vlorë dhe nga KLSH. Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr.453, datë 18.06.2014 ka shpallur fajtor përgjegjësit për shkeljet ligjore, për veprën penale të shpërdorimit të detyrës dhe falsifikimit të dokumenteve. Me Vendimin nr. 91, datë 15.05.2013 Këshilli i Komunës ka vendosur anullimin e kontratave të lidhura nga ish-Kryetari Komunës për dhënien e tokave me qira dhe tjetërsimin e objekteve sociale, që janë bërë në kundërshtim me ligjet në fuqi. Me këtë vendim të njërës palë nuk mund të zgjidhen kontratat, pasi në kreun e Kontratës “Zgjidhja e mos marrëveshjeve” përcaktohet: “Ndërmjet palëve, çdo mosmarrëveshje lidhur me zbatimin e detyrimeve ose interpretimin e kushteve të kësaj kontrate, në rast se nuk zgjidhet me mirëkuptim, çështja i paraqitet për gjykim Gjykatës së Rrethit në Jurudiksionin e të cilës ndodhet toka bujqësore”. Pra anulimi i kontratave bëhet vetëm me Vendim të Gjykatës të formës së prerë. Në këto kushte këto kontrata janë në fuqi. Për periudhën nga momenti i konstatimit të paligjshmërisë së lidhjes së kontratave deri në momentin e marrjes së vendimit të anulimit të këtyre kontratave qiramarrësit kanë detyrime kontraktore për likuidimin shumave të qirave vjetore të përcaktuara këto në paketat fiskale të viteve përkatëse (vitet 2010-2013).

Nga komuna nuk është kryer procedura e marrjes në dorëzim me procesverbal të parcelave të dhëna me qira, pra fermerët që kanë marrë me qira tokat edhe pse është marrë vendimi për anulimin e kontratave, i kanë në përdorim këto parcela deri më sot. **Mos pagesa dhe mos derdhja në arkën e Komunës e detyrimit të shumës së qirasë nga qiramarrësit deri në momentin e anulimit të kontratave** është në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil në Republikën e Shqipërisë” neni 420 i cili përcakton: “Detyrimet lindin nga kontrata” dhe nenit 693 që përcakton se “Kontrata i detyron palët jo vetëm përpara është parashikuar, por edhe për të gjitha pasojat që rrjedhin nga zbatimi i ligjit”, si dhe me kreun V pika 2 të Udhëzimit KM nr.1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”.

**Rekomandim:** Bashkia Vlorë (e cila ka përfshirë komunën Novoselë nga shkrirja si njësi vendore) të marrë masa dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve kontraktore të pashlyera në shumën **3,313,719 lekë** nga **39 përdoruesit**, të parcelave të marra me qira nga fondi i tokave të pandara pronë e kësaj njësie vendore, sipas aneksit nr.1 bashkëlidhur raportit auditimit.

**8. Gjetje nga auditimi:** Janë bërë pagesa për udhëtim e dieta pothuajse në të gjitha rastet për të njëjtët punonjës, për vitin 2013 në 9 raste për 362,500 lekë dhe për vitin 2014 në 11 raste për 371,500 lekë dhe për vitin 2015 në 1 rast për 50,000 lekë, ku autorizimet e titullarit nuk përcaktojnë qëllimin dhe arsyen e shërbimit, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës” dhe me nenin 4/26 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011”, rubrika “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve” pika 34, 35, 36, duke shkaktuar dëmin ekonomik në shumën **117,000 lekë**.

**Rekomandim:** Të arkëtohet vlera **117,000 lekë** nga punonjësit: Sh.M 37,500 lekë, K. K 6,000 lekë, R.H 22,500 lekë, Sh.M 21,000 lekë, D.A 10,500 lekë, O.A 4,500 lekë, J.H 6,000 lekë dhe A.H 9,000 lekë, të cilët kanë përfituar dieta në mënyrë të paargumentuar.

**9. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi u konstatua se në 18 raste pagesash me muajt respektive të lëvizjeve, urdhërshebimet për dietat e A.L dhe A.N me detyrë shofer nuk korrespondonin me fletë-udhëtimet e mbajtura, për justifikimin e përdorimit të karburantit, për destinacionet e lëvizjeve në të njëjtat data. Pra për të njëjtën ngjarje janë mbajtur dokumenta financiare të ndryshme, të cilët nuk pasqyrojnë me vërtetësi ngjarjen e ndodhur, në kundërshtim me pikën 26 të nenit 4 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011”, rubrika “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve” pika 34, 35, 36, 37, duke shkaktuar dëmin ekonomik në vlerën **253,500 lekë**.

**Rekomandim:** Të arkëtohet vlera **253,500 lekë**, nga A.L 238,000 lekë dhe A.N 15,500 lekë, pasi kanë përfituar dieta mbi bazën e dokumenteve financiare të parregullta.

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga krahasimi i fletëdaljeve të magazinës për karburantin e bërë dalje me fletë udhëtimet e plotësuara për karburantin e përdorur për çdo automjet, rezultoi se për automjetin fadromë nuk është mbajtur dokumentacion justifikues dhe vërtetues i përdorimit të 5,540 litra karburant, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 34, 35, 36, me pasojë **dëmin ekonomik** në vlerën **981,250 lekë**.

**Rekomandim:** Bashkia të marrë masa që të ngrëjë grup pune me specialistë përkatës dhe të bëjë ri llogaritjen e shpenzimeve për përdorimin e karburantit për fadromën, të nxjerrë diferencat dhe të kërkojë zhdëmtimin nga personat përfitues për vlerën **981,250 lekë**.

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i fletë-udhëtimeve të mbajtura për argumentimin e karburantit të përdorur rezultoi se përse i përket distancave të shënuara në disa raste nuk ishin të sakta. Kështu në fletë udhëtimet e plotësuara të automjetit me targë 3320B dhe i automjetit me targë AA563CZ u konstatuan disa pasaktësi në përcaktimin e distancave Novoselë-Tiranë, në kundërshtim me VKM nr. 66, datë 7.2.2007, duke shkaktuar **dëmin ekonomik** në vlerën **547,782 lekë**.

**Rekomandim:** Bashkia të marrë masa që të ngrëjë grup pune me specialistë përkatës dhe të bëjë ri llogaritjen e shpenzimeve për karburant të pajustificuar, të përdorur mbi limitin ligjor të distancave të përshkruara në fletë-udhëtimet e hartuara, për 2 automjetet me targa VL 3320 B dhe AA563CZ, të nxjerrë diferencat dhe të kërkojë zhdëmtimin nga personat përfitues për vlerën **547,782 lekë**.

## C. MASA ADMINISTRATIVE

Nga auditimi në komunën Novoselë për vitin 2013-2015, u konstatuan disa shkelje të kërkesave të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar.

Bazuar në germën “ç” të nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, date 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, bazuar në VKM nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së Licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ndryshuar me VKM nr. 92, date 19.02.2014, Kreu VII, “Sanksione”, pika 1, shkronja (a), Pika I- Konstatohen ose provohen deklarime, të rreme, **rekomandojmë Komisionin e dhënies së Licencave, pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban**, që për shkelje të ligjshmërisë në ndërtim të vendosë sanksionet nga “Gjobë” deri në “**Heqje e Licencës së ushtrimit të profesionit me afat,**” për:

**1. znj. Ing. Sh.M, nën cilësinë e projektueses dhe kolaudatores**, për shkeljet e konstatuara, si më poshtë:

-për kryerjen e kolaudimit dhe hartimit të projektit për objektin “*Rikonstruksioni i rrugës Hidrovor Akërrni faza e II*”, Novoselë nga i njëjti person (Sh.M), në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar paragrafi i dytë.

- Në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt “*Ndërtimi i shkollës së re 9- vjeçare Pilo Prifti*” me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën 3,164,256 lekë për punë të pakryer si dhe për mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 3.

**2. zj. Ing. D.Q, nën cilësinë e mbikëqyrësit dhe kolaudatores të punimeve**, për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

-në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt “*Ndërtimi i shkollës së re 9 - vjeçare Pilo Prifti*” me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e Komunës Novoselë në vlerën 3,164,256 lekë pa T.V.SH për punë të pakryer si dhe për mangësi në dokumentacion;

-në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt “*Ndërtimi i shkollës në fshatin Poro*” me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën 185,850 lekë.

Veprime këto në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar si dhe me Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit””, pika 4.

**3. zj. ing. A.K, nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve**, për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

- në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt “Ndërtimi i shkollës në fshatin Poro” me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale 185,850 lekë pa T.V.SH, për punime të pakryera, në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3.

## **D. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në germa “e” dhe “ç”, neni 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale tip, i rekomandojmë **Kryetarit të Bashkisë Vlorë** (në të cilën është përfshirë komuna Novoselë), fillimin e procedurave administrative për dhënien e masës disiplinore, nga “Vërejtje” deri “Ndërprerje të marrëdhënie të punës”, sipas shkallës së përgjegjësisë, për këta persona:

**1. Znj. Sh.M me detyrë Përgjegjëse e Urbanistikës dhe në cilësinë e Kryetares të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe në cilësinë e hartimit të preventivave për punime në procedurat e blerjeve me vlera të vogla**, për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos hartimin e vërtetimi i përputhshmërisë në fund të procesit të zhvillimit nga Zyra e Urbanistikës së Komunës për lejen për zhvilluesin “Jano” shpk për punimet: “Ndërtimi I objektit Magazinë për përpunimin dhe grumbullimin e ullirit, lënda e parë (shitesë në fabrikën ekzistuese)”, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 110/2013, datë 01.04.2013 “Për Planifikimin e Territorit” të azhurnuar, neni 70/30 “Vërtetimi i përputhshmërisë së zhvillimit” pika 1.

- Për mos inventarizimin e dokumentacionit, kërkesat për leje, miratimet e lejeve sipas dosjeve përkatëse dhe e nënshkruar nga personat përgjegjës, sipas kërkesave të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”

-Në blerjet me vlera të vogla të materialeve të ndërtimit për mirëmbajtje rrugësh (rërë bituminoze, çakëll dhe stabilizant) në 2 raste mungon preventivi paraprak dhe në 2 raste të tjera edhe pse është hartuar preventivi paraprak është i mangët si dhe nuk është i shoqëruar me plan vendosje, nuk përcakton trashësinë e shtresave, specifikimin teknik dhe çmimet nuk i referohen manualeve të miratuara për punime të ndërtimit në kundërshtim me ligjin nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar me pikën 3.1 dhe 8.3, Kreu I i UKM nr. 2 datë 13.05.2005.

-Për shkelje të procedurave të prokurimit në tenderin me objekt: “Blerje e 3 automjeteve vetëshkarkuese për komunën Novoselë”, pasi subjekti fitues Procuall shpk nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit, i mungon mandat arkëtimi që vërteton pagesën e taksave vendore të vitit 2012, por është mjaftuar me disa vërtetime të drejtorisë taksave vendore të bashkisë Tiranë nr. 1776, datë 02.8.2012, të drejtorisë taksave vendore të bashkisë Lushnjë nr. 513, datë 27.7.2012, vërtetime të cilat nuk përfshihen tek kriteret e veçanta të kualifikimit të DST, për rrjedhojë KVO operatorin ekonomik P....l shpk duhej ta skualifikonte. Veprime në kundërshtim me pikën 4 “kriteret e veçanta të kualifikimit” të DST, me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 53, “Shqyrtimi i ofertave” dhe me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V “zhvillimi i procedurave”.

Për marrjen në dorëzim 3 automjetet vetëshkarkuese në kundërshtim me specifikimet teknike të tenderit, pasi janë me tonazh 960 kg nga 2,500 kg që duhej dhe fuqi motorrike 1498 Cc nga 1,800 Cc që duhej, sipas procesverbalit të komisionit të marrjes në dorëzim datë 21.5.2013,

lejeve të qarkullimit, aktpronësive të mjeteve dhe faturës së origjinës të subjektit, në kundërshtime me kontratën nr.633/1, datë 16.5.2013, neni “detyrimet e palëve”.

Për rrjedhojë kemi mos efektivitet të përdorimit të fondeve publike për 759,000 lekë.

-Për shkelje teknike procedurash ( *pa efekte financiare*) në tenderin e zhvilluar në vitin 2014 me objekt “*Shkolla e re në Poro Komuna Novoselë*”, pasi asnjë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender nuk plotësonin kriteret për kualifikim. Në këto kushte komisioni i vlerësimit të ofertave nuk duhej të vazhdonte procesin e përzgjedhjes së fituesit dhe tenderi duhej të përsëritej, pasi është vepruar në mospërputhje VKN nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu VII, pika 1, “Mungesa e konkurrencës”, germa “a”.

**2. Z. A.H, me detyrë shef administrate dhe në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, dhe me detyrën Përgjegjës i Sektorit të Bujqësisë,** për shkeljet e mëposhtme:

-Për shkelje të procedurave të prokurimit në tenderin me objekt: “*Blerje e 3 automjeteve vetëshkarkuese për komunën Novoselë*”, pasi subjekti fitues *Pr...l shpk* nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit, i mungon mandat arkëtimi që vërteton pagesën e taksave vendore të vitit 2012, por është mjaftuar me disa vertetime të drejtorisë taksave vendore të bashkisë Tiranë nr. 1776, datë 02.8.2012, të drejtorisë taksave vendore të bashkisë Lushnje nr. 513, datë 27.7.2012, vertetime të cilat nuk përfshihen tek kriteret e veçanta të kualifikimit të DST, për rrjedhojë KVO operatorin ekonomik *Procual shpk* duhej ta skualifikonte. Veprime në kundërshtim me pikën 4 “*kriteret e veçanta të kualifikimit*” të DST, me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 53, “Shqyrtimi i ofertave” dhe me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Kreu V “zhvillimi i procedurave”. Për rrjedhojë kemi mos efektivitet të përdorimit të fondeve publike për 759,000 lekë.

-Për shkelje teknike procedurash ( *pa efekte financiare*) në tenderin e zhvilluar në vitin 2014 me objekt “*Shkolla e re në Poro Komuna Novoselë*”, pasi asnjë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender nuk plotësonin kriteret për kualifikim. Në këto kushte komisioni i vlerësimit të ofertave nuk duhej të vazhdonte procesin e përzgjedhjes së fituesit dhe tenderi duhej të përsëritej, pasi është vepruar në mospërputhje VKN nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu VII, pika 1, “Mungesa e konkurrencës”, germa “a”.

- Në detyrën e Përgjegjësit Sektorit të Bujqësisë (*për periudhën 29.11.2013-30.06.2015*), i cili në kundërshtim me VKM nr. 121, datë 17.02.2011 “*Mënyra e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe bashki*” Kreu IV pika 2, shkronja c:

- Për lejjimin dhe përdorimin e paligjshëm e shfrytëzimin e parcelave me sipërfaqe 52.9 ha i fondit pyjor pasuri në pronësi të Komunës, për kultivime bujqësore pa pasur marrëdhënie ligjore (pronësi a qiraje) lidhur me tokën, në kundërshtim me ligjin nr. 8312, datë 26.3.1998 “Për tokat bujqësore te pandara” neni 6, me ligjin nr. 9791, datë 23.7.2007 “Për disa ndryshime ne ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” neni 40/3 *me pasojë përfitime të paligjshme që përbëjnë të ardhura të munguara për Buxhetin e Komunës në vlerën totale prej 1,848,138 lekë.*

- Për procedimin e dhënies me qira të sipërfaqes prej 2 ha të tokës së pandarë z. Benjamin Bedini në kundërshtim me ligjit nr. 8312, datë 26.3.1998 “*Për tokat bujqësore të pandara*” i ndryshuar neni 8 dhe të pikës 4 të vendimit nr. 531, datë 21.8.1998 të Këshillit të Ministrave “Për tokat bujqësore të pandara” i ndryshuar pika 4, ligjin Udhëzimit të KM nr. 1, datë 18.7.2012 “*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*” dhe Urdhrit të Ministrisë të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nr. 234, datë 9.7.2007 “*Për miratimin e përmbajtjes dhe formës së kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore, të pandara, pasuri shtetërore*” dhe të “*formularit tip të kërkesës për qiramarrje të tokës bujqësore*”.

- Për mos ndjekjen e kontratave dhe arkëtimin e detyrimit kontraktor të shumës së qirasë nga 39 qiramarrësit deri në momentin e anulimit të kontratave, në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “*Kodi Civil ne Republikën e Shqipërisë*” neni 420 dhe 693, me pikën V/2 të Udhëzimit KM nr. 1 datë 18.7.2012 “*Për procedurat e*

dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, me pasojë dëmin ekonomik në shumën 3,313,719 lekë

**3. Z. L.M me detyrë Përgjegjës i Policisë Komunës dhe në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, dhe me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve,** për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos mbajtjen e planeve mujore të punës të policisë komunës dhe mos vendosjen e asnjë gjobe për kundravajtjet si dhe mos tërheqjen e blloqeve të gjobave nga financa, në kundërshtim me nenin 14 pika 8 e urdhrin të përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Ministrit të Rendit Publik nr. 1 datë 17.04.2003 “Për miratimin e rregullores TIP të policisë bashkiake dhe të komunës”, për periudhën e auditimit për vitin 2013-2015.

-Për marrjen në dorëzim 3 automjetet vetshkarkuese në kundërshtim me specifikimet teknike të tenderit, pasi janë me tonazh 960 kg nga 2,500 kg që duhej dhe fuqi motorrike 1498 Cc nga 1,800 Cc që duhej, sipas procesverbalit të komisionit të marrjes në dorëzim datë 21.5.2013, lejeve të qarkullimit, aktpronësive të mjeteve dhe faturës së origjinës të subjektit, në kundërshtime me kontratën nr.633/1, datë 16.5.2013, neni “detyrimet e palëve”. Për rrjedhojë kemi mos efektivitet të përdorimit të fondeve publike për 759,000 lekë.

- Për mos hartimin dhe mos administrimin e kërkesave për përcaktimin nevojave për blerjet me vlera të vogla, dhe në rastet e punimeve të shoqëruara këto me preventivat përkatës si dhe mos hartimin e dokumentacionit teknik për punën e kryer me punëtorët e mjetet e Komunës deri në dorëzimin e tyre në Sektorin e Financës, në kundërshtim me VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pikës 2/a Kreu i VI, me ligjin nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar me pikën 3.1 dhe 8.3, Kreu I i UKM nr. 2 datë 13.05.2005, me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 34, 35, 36 e 37, 42, 43 e 44, me UMF nr.33 datë 11.07.2013 e UMF nr.57 datë 12.6.2014 “Për Gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” tabela1/3.

**4. Zj. M.P me detyrë K/Inspektore e INUV sot IMKTV,** për shkeljet e mëposhtme:

-Për punë të dobët në funksionimin si Kryeinspektore INUV sot IMKTV të Komunës Novoselë për periudhën e vitit 2013, 2014 dhe 5-mujorin 2015, megjithëse është jashtë profesionit që kërkon vendi i punës, konkretisht inxhinier ose teknik i mesëm ndërtimi, në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit” neni 11.

-Për mos aplikimin e sanksioneve për 26 ndërtime pa leje, pasi 21 vendime pezullimi nuk janë shoqëruar me vendime prishje, nuk është vendosur asnjë gjobë dhe nuk është bërë asnjë kallxim penale për ndërtimet e paligjshme, në kundërshtim me nenin 75 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, me nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit”, me nenin 15/a të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” Kreu III Sanksionet, ndryshuar me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007 etj., me nenin 81 “Sanksionet” të ligjit të Urbanistikës dhe pikës 8 të VKM nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të Kontrollit të teritorit nga Inspektoriati ndërtimor e Urbanistik kombëtar e Vendor.

-Për mos mbajtjen e dosjeve të Inspektoriatit ndërtimor Urbanistik dhe mos inventarizim e dokumentacionit si dhe mos dorëzimin e tyre në zyrën e arkivit, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat “.

**5. Z. P.R me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Taksave vendore,** për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos realizimin e të ardhurave vendore të Komunës Novoselë për vitin 2013 dhe 2014 në total dhe sipas strukturës analitike, i cili paraqitet në masën 50%, konkretisht për vitin 2014 realizuar 21,298 mijë lekë nga 41,304 mijë lekë planifikimi, ose 51 %.

-Për mos planifikimin e taksës therjes bagëtive, në kundërshtim me pikën 10 të paketës fiskale të miratuar sipas vendimit të Këshillit Bashkiak nr.120, datë 24.01.2014, dhe taksës hapësirës publike, në kundërshtim me pikën 4/e të paketës fiskale të miratuar sipas vendimit të Këshillit Bashkiak nr.120, datë 24.01.2014.

- Për mos vjeljen dhe ndjekjen e Debitorët e taksave vendore, të cilët paraqiten në nivele të larta për vlerën 90 milion lekë

-Për mos dërgimin e shkresës në adresë të financës për kontabilizimin e debitorëve. Mos arkëtimi i debitorëve, mungesa e masave sekuestruese ndaj tyre, mungesa e lëshimit të autorizimit të ndërhyrjes me forcë të Policisë Komunes për disiplinimin e debitorëve, bie ndesh me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" neni 88 e 93, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", neni 17 "Kundërvajtjet dhe sanksionet", pika 3, me Rregulloren e Brendshme të Komunes të miratuar në Këshillin Bashkiak neni 41 dhe 42.

**6. Zj. D.L, me detyrë Përgjegjëse e Ndihmës Ekonomike, në cilësinë e kryetares ë komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi për vitin 2014,** për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos hartimin e relacionit për kryerjen e vlerësimit të aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimi, ku të bëhej argumentimi përkatës dhe të shpreheshin për destinimin e mëtejshëm të tyre pas miratimit të nxjerrjes jashtë përdorimit.

- Për mos mbajtjen e procesverbaleve për përkrahimin e destinacionit të fundit të këtyre aktiveve për kryerjen e hapave të mëtejshëm për tjetërsimin apo asgjësimin e tyre, në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 109.

**7. Zj. D.A me detyrë Kryetare e Degës së Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe në cilësinë e kryetares së KPVV për periudhen (14.10.2014-30.06.2015) dhe inspektore provizore taksave vendore,** për shkeljet e mëposhtme:

- Për mangësitë dhe parregullsitë në plotësimin e dokumentave pjesë të dosjes së procedurave të blerjeve me vlera të vogla, në kundërshtim me VKM nr 1 datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" pikës 2/a Kreu i VI, Udhëzimet e APP "për procedurën e prokurimit me vlera të vogla", me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 37, 42, 43 e 44, me UMF nr.33 datë 11.07.2013, me UMF nr.57 datë 12.6.2014 "Për Gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë" tabela1/3.

- Për pagesat e shpenzimeve për udhëtim e dieta mbi bazën e dokumentave të parregullta autorizues vërtetues, në kundërshtim me VKM nr .997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës" dhe me ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" neni 4 pika 26 dhe me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 34, 35, 36, 37.

- Për mos ndjekjen e llogjikës kontabël në nxjerrjen e bilancit kontabël (në mungesë të librit të madh apo sistemit centralizator), në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar dhe me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël" i ndryshuar.

**8. Zj. O.A me detyrë llogaritare e parë në Sektorin e financës që administron dhe kontabilizon dokumentacionin e magazinës, në cilësinë e anëtares së KPVV (për periudhen 14.10.2014 -30.06.2014),** për shkeljet e mëposhtme:

- Për mangësitë dhe parregullsitë në plotësimin e dokumentave pjesë të dosjes së procedurave të blerjeve me vlera të vogla, në kundërshtim me VKM nr, 1 datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" pikës 2/a Kreu i VI, Udhëzimet e APP "për procedurën e prokurimit me vlera të vogla", me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 37, 42, 43 e 44, me UMF nr. 33 datë 11.07.2013, me UMF nr.57 datë 12.6.2014 "Për Gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë" tabela1/3 dhe me UMF nr. 30 datë 27.12.2011.

- Për mos administrimin e dokumentacionit të plotë të harxhimit të karburantit dhe kontabilizimin e veprimeve ekonomike mbi bazën e dokumentave autorizues e justifikues të parregullta e të paplota mbi bazë të të cilave janë prerë fletë-daljet e këtij aktivi, në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 34, 35, 36 e 37, me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël" i ndryshuar.

**9. Zj. Z.B me detyrë veteriniere e komunës,** për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos aplikimin dhe vjeljen e taksës therjes për bagëtitë e trasha dhe të imta, për vitin 2013 dhe 2014 dhe 2015, në thertoren e subjektit Nikos Semanjakos, e cila është dhënë me qira sipas kontratave datë 27.8.2014 dhe 26.3.2015, në kundërshtim me pikën 9 të paketës fiskale të miratuar sipas vendimit Këshillit Komunës nr.73, datë 28.12.2012, çka ka krijuar efekte mungesë të ardhurash për këtë taksë.

Nga Bashkia Vlorë, ku bën pjesë Njësia Administrative Novoselë (ish komuna), është kthyer përgjigje brenda afatit ligjor, së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë në proces vlerësimi e zbatimi.**

**Shënim:** Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Besim Bileri, Irma Shkupi, Abdulla Duka deh Jinild Hoxhaj, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**